



sollën në vend, edhe pse vendi ishte nën një formë tutele. Pra, edhe pse nën okupacion italianët sollën një zhvillim ekonomik në Shqipëri dhe fillimshkullit të 20-të, deri në Luftën e Dytë Botërore. Më pas, paraqitet edhe fraktura e madhe që erdhi nën regjimin komunist. Shqipëria, nga një kufi i Perandorisë Osmane bëhet një kufi i sistemit sovjetik, dhe kjo është një tjetër karakteristikë e territorit shqiptar që duket se gjithmonë është kufi i diçkaje. Pra, në fillim ishte kufi i Perandorisë Otomane në Ballkan, një kufi i stabil, më pas me sovjetikët bëhet një kufi i sistemit komunist, edhe ne e dimë se më vonë Shqipëria merr një rrugë tjetër, sepse në Bashkimin Sovjetik fillon destalinizimi, ndërsa këtu ka një konotacion totalisht stalinist. Prishen marrëdhëniet me BS-në e përmirësohen e afrohen me Kinën Komuniste. Edhe brenda botës komuniste Shqipëria kishte një lloj originaliteti. Vendi juaj që nën një regjim që ishte një prej regjimeve më të mbyllura, më të rënda nga ato të të gjitha vendeve të tjera komuniste.

Ky libër është botuar më parë në italisht. Çfarë ndikimi pati atje?

Në Itali ka pasur një efekt të madh, ose le të themi një habi, kur u mor vesh se këtu është shkatërruar edhe flota e peshkimit, sepse përmes mjeteve lundruese të flotës njerëzimit mund të arratiseshin e të iknin nga vendi. Këtu ka pasur shumë gjëra që u limituan, u kufizuan për shkak të pushtetit. Këto janë fakte që nuk janë vënë re shumë, siç mund të ishte disidenca në Shqipëri, ku persekucioni i disidentëve ishte mjaft i lehtë. Ne i kemi kontrolluar arkivat në Shqipëri për kohën e komunizmit. Kemi kërkuar të dhëna dhe informacione për marrëdhëniet e komunistëve italianë me komunistët shqiptarë. Partia Komuniste italiane ishte e ndarë në dy linja. Ishin disa që qenë filloshqiptarë, e disa të tjerë, edhe pse ishin komunistë nënvizionin këtë lloj forme komuniste që nuk kishte arsytetime logjike, e që ishte kaq fort to-

talitare. Ka edhe pjesë të tjera të mozaikut të historisë që flasin për raporte mes dy vendeve që i ndante Adriatiku e që kanë një histori me shumë të përbashkëta.

Mes Partisë Komuniste shqiptare dhe asaj italiane, ka pasur marrëdhënie apo takime? Çfarë mund të na thonin mbi këtë çështje?

Le të themi se ndodh kjo. Elementët më ekstremë të Partisë Komuniste italiane, që më vonë do të dalin fare nga kjo parti, financohen nga kinezët përmes Tiranës, për aktivitetet e tyre politike në Itali. Por ka edhe histori interesante në nivelin e "bizneseve të vegjël", por këtë do ta shohim kur të dalë libri.

Sa i takon periudhës së qëndrimit dhe ndikimit italian në Shqipëri në vitet para Luftës së Dytë Botërore, çfarë i shtoi atyre fakteve që njihen tashmë?

Në atë aksion, le të përdorim këtë fjalë, italianët kanë lënë shumë gjurmë të tyre këtu. Italianët kudo që kanë shkuar kanë ndërtuar, kanë lënë arkitekturën e tyre, siç kanë bërë më përpara romakët. Ajo periudhë mes dy luftërave ka një pjesë interesante, do të thosha unë, sepse tutela nën të cilën Italia ka vënë Shqipërinë, në një farë mënyre i garanton edhe pavarësinë këtij vendi që nuk kishte shumë kohë që e kishte shpallur atë. Pastaj, e gjitha kjo në fakt do të modifikohet në një tjetër ide, me futjen e vendit tuaj në mbretërinë italiane përmes përdorimit të ushtrisë. Më vonë do të vijë edhe pjesa negative, sepse italianët do të gjejnë rezistencë, e po ashtu do të ketë njerëz që bashkëpunojnë e të tjerë që dalin kundër.

Ka pasur ide të hedhura se Mbreti Zog ia "dorëzoi" vendin italianëve...

Personazhi i Zogut është një personazh disi mjaft i thellë, sepse siç e dimë ai nuk vinte nga ndonjë dinasti, e ndaj në një farë mënyre ai vetëprogramohet si mbret. Italianët e mbështesin deri në një farë pike, deri sa vjen okupimi ushtarak. Zogu është

Komunistët italianë

"Ne i kemi kontrolluar arkivat në Shqipëri për kohën e komunizmit. Kemi kërkuar të dhëna dhe informacione për marrëdhëniet e komunistëve italianë me komunistët shqiptarë. Partia Komuniste italiane ishte e ndarë në dy linja".

një figurë që "gjendet" shpesh në historinë e vendeve që arrijnë vonë formimin e shtetit kombëtar, sepse Shqipëria e kishte arritur vonë këtë moment. Ndaj në krahasim me mbretëritë e tjera, ka pasur shumë vështirësi në ndërtimin e institucioneve dhe duke pasur parasysh që i duhet të përballojë një shekull të vështirë në planin e raporteve ndërkombëtare, ishin italianët, gjermanët, kontrolli i Adriatikut nga Italia. Dalja nga Pakti i Versajës lexohet sot si një tentativë për të ruajtur pavarësinë e Shqipërisë, që më pas do të bëhet një formë ndryshe e politikës së Shqipërisë.

Është një pjesë e historisë sonë jo shumë e eksploruar. Ka të bëjë me pushtetin e disa ushtarëve italianë në Shqipëri nga komunistët, pas kapitullimit të Italisë. Ju e keni prekur këtë moment në librin tuaj?

Diçka mbi këtë është vënë re, por më i vënë re dhe më i prekur është problemi i fëmijëve që lindën nga lidhjet apo martesat e grave shqiptare me italianët që ishin këtu gjatë luftës. Diçka për këtë flitet, e disa dëshmi janë dhënë. Por, këto janë çështje që vështirë të gjenden të dokumentuara, sepse në arkiva si në Itali po ashtu edhe në Shqipëri ka disa episode që të gjithë duan ose t'i fshehin, ose t'i harrojnë, ose nuk ka fare dokumente sepse këto kanë dalë nga mekanizmi i sistemit burokratik që ruan letrat apo dëshmitë e të dhënat mbi to. Ndaj, ushtarë italianë që kanë dezertuar e që për motive ideologjike mund t'u jenë bashkuar shqiptarëve, ose të tjerë që kanë qëndruar me gra shqiptare këtu, janë fshehur. Por, dëmi më i madh iu është bërë të bijve të tyre, fëmijëve të lindur nga një prindër italian e një shqiptar. Ata ishin "toka e askujt", komunistët nuk i donin, se ishin bijë të italianëve fashistë e të tradhtarëve shqiptarë. Në Itali, ose nuk dihet ekzistenca e tyre, ose nuk donin t'ia dinin, e fëmijët mbetën as shqiptarë, as italianë, dhe nuk iu njihje asnjë e drejtë.

Para pak ditësh në Shqipëri është botuar një libër historie për shkollat e mesme. Në këtë libër, ndër të tjera trazirat e vitit 1997, cilësohen si rebelim komunist. Profesor, meqenëse në librin tuaj ju keni folur edhe për këto rrënuja, e duke qenë se ju nuk jeni i lidhur as drejtpërdrejt e as anasjelltas me politikën shqiptare, si e cilësoni atë që ndodhi në '97-ën?

Në realitet është bashkimi i dy elementëve të ndryshëm. Nga njëra anë është kriza që lind nga spekulimi. Unë mendoj se janë forma rebelimi që nuk kanë të bëjnë me ideologjinë. Nga eksperiencat e vendeve ish-komuniste, elementët e partive të vjetra komuniste kthehen në qarkullim, por nuk kthehen me idenë të rikrijojnë ndonjë sistem politik. Më shumë se ta lexojmë si një rikthim të komunizmit, 1997-ta mund të lexohej si element i rrëmujës që vinte në Shqipëri për shkak të vështirësisë për të formuar një qeveri të qëndrueshme, ose të problemeve ekonomike. Ajo që ndodhi, nuk erdhi për shkak të komunizmit, as të ideologjisë, por për shkak të problematikës ekonomike dhe zhgënjimit të popullit që mendonte se me ardhjen e demokracisë shumë gjëra do të ndryshonin.

Prej sa kohësh merreni me historinë e Shqipërisë?

Duke qenë se unë jam profesor i Historisë së Europës orientale në Universitetin "La Sapienza", ndaj historinë e Shqipërisë e studioj që në kohën që jam marrë me këtë profesion, mendoj se kanë qenë vitet 1970.